

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5804
E martë, 18 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Për dy vjet, tetë raste të vdekjeve në burgjet e Kosovës | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



PËRKUJTOHET VETERANI I LUFTËS SË UÇK-SË DHE BABAI I TRE HERONJVE, HILMI HARADINAJ F. 6

BYTYQI: KOSOVËS I DUHEN DREJTORË TË MIRË TË SHKOLLAVE F. 5

EKONOMI



SHOQËRIA CIVILE MARSHOI KUNDËR PROJEKTLIGJIT PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE F.7

LANSOHET EDICIONI I DYTË I FONDIT TË INOVACIONIT F.8

KULTURË

MIRATOHET STRATEGJIA PËR RINI F.4



SPORT

LLAPI U BRAKTIS NGA LOJTARËT QË LAVDËROHESHIN NGA BATATINA F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", BESNIK TAHIRI ■ FAQE 4-5

Ligji për qeverinë do të miratohet këtë vit

- Qeveria nuk do të ketë më shumë se 15 ministri, 30 zëvendësministra si dhe nuk do të ketë zëvendëskryeministra pa portofol



Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se gjatë këtij viti do të miratohet Ligji për qeverinë. Ai ka thënë se me këtë ligj qeveria nuk do të ketë më shumë se 15 ministri, 30 zëvendësministra si dhe nuk do të ketë

zëvendëskryeministra pa portofol. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se ky ligj përmirëson efikasitetin dhe funksionalitetin e ekzekutivit. Duke folur për reformën shtetërore, ai ka thënë se nuk ka reformë e cila nuk është e

dhimbshme. Megjithatë, Tahiri ka vlerësuar se reforma mund të jetë në disfavor të partive që udhëheqin qeverinë, por gjithmonë është e pëlqyer nga shoqëria. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës reformën në administratën shtetërore e ka kryesoren

Ministrat zotohen për kryerjen e punëve që dalin nga raporti i Komisionit Evropian

Disa nga ministrat e Qeverisë së Kosovës janë zotuar të hënë para ambasadorëve të vendeve të BE-së në Prishtinë se do t'i kryejnë të gjitha detyrat që dalin nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. Ata kanë treguar se pas publikimit të raportit për vendin kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm duke identifikuar të gjitha mangësitë, boshllëqet dhe rekomandimet e raportit për vendin dhe për t'ua përcjellë ato institucioneve përgjegjëse | FAQE 9



Fillon Java e Shëndetësisë Kosovë - Turqi, synohet rritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ■ FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Scotti: Liderët politikë në Ballkan ta lënë mënjanë retorikën nacionaliste

BEOGRAD, 17 QERSHOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi, Kyle Scott, ka deklaruar të hënën se "status quo"-ja në Ballkan nuk është e qëndrueshme dhe se "të gjithë po humbasin për shkak të ndalimit

në negociatë". "Ata që besojnë se do të vijnë kushte më të mira në të cilat do të negociohet një marrëveshje më e favorshme, duhet ta dinë se nuk ka asnjë moment më të mirë se kjo", ka shkruar Scotti në llogarinë e vet në "Twitter". Ai ka thënë se udhëhe-

qësit politikë duhet ta lënë mënjanë retorikën nacionaliste dhe revizionizmin historik pasi, sipas tij, rihapin plagët e të mbijetuarve dhe parandalojnë përparimin drejt aritjes së një qeverie transparente, demokratike dhe të përgjegjshme.



Partia Socialiste kërkon zyrtarisht shkarkimin e presidentit Meta

Një grup prej 55 deputetësh socialistë, në kërkesën e tyre drejtuar Parlamentit për shkarkimin e presidenti Meta, deklaruan se anulimi i datës së zgjedhjeve vendore është në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një republike parlamentare, me funksionet e postit të tij dhe me ushtrimin normal të sovranitetit nga populli



informacion për 122 e deputetët në Kuvend dhe përkatësinë e tyre në zona zgjedhore. Kërkesa e presidentit drejtuar KQZ-së u interpretohet si një hap paraprak i tij për t'i studiuar mundësitë e shpërndarjes së Parlamentit. Kur parlamenti miratoi me 100 vota rezolutën kundër dekretit të presidentit Meta, i cili tashmë ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, ky la të kuptohet se parlamenti ekzistues, me deputetët zëvendësues, nuk është legjitim: "Presidenti është zgjedhur nga Parlamenti. Natyrisht jo nga ky, por nga një parlament krejtësisht legjitim", tha Meta.

TIRANË, 17 QERSHOR - Një grup prej 55 deputetësh socialistë i kërkuar të hënën Parlamentit ta shkarkojë presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, për shkak të anulimit të datës së zgjedhjeve vendore. Ata deklaruan se ky akt i presidentit është në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një republike parlamentare, me funksionet e postit të tij dhe me ushtrimin normal të sovranitetit nga populli. "Meta e ka humbur të drejtën të qën-

drojë në atë zyrë me pëlqimin tonë. Ne socialistët nuk i përkasim kulturës politike të arbitraritetit dhe dhunimit të ligjit dhe do ta ndjekim rigorozisht procedurën e parashikuar në rastin e shkarkimit presidentit", tha kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. Deputetët socialistë shtuan se presidenti dekretoi datën e zgjedhjeve dhe mbi bazën e atij dekreti nisën një seri përgatitjesh

të procesit zgjedhor, të cilat ai nuk mund t'i prapësojë më. Ata cituan një varg nenesh të Kushtetutës dhe komentesh, sipas të cilëve, presidenti ka shkelur parimin kushtetues se sovraniteti i takon popullit, ka njoftuar voa. "Anulimi i datës 30 qershor si datë e mbajtjes së zgjedhjeve për organet e pushtetit ven-

dor dhe më e rëndë akoma, moskaktimi i një date tjetër për mbajtjen e tyre, mohon në thelb të drejtën e sovranit për të qenë i tillë", shënojnë deputetët në kërkesën e tyre drejtuar parlamentit. Ndërkaq Komisioni Qendror i Zgjedhjeve iu përgjigj të mërkurën kërkesës së presidentit Meta për

Presidenti Meta ka nisur konsultimet me partitë politike për një datë të re zgjedhesh vendore. Ai ka zhvilluar takime me disa parti të opozitës, por socialistët po vazhdojnë fushatën për t'i realizuar zgjedhjet më 30 qershor.

Meta u dërgon letër ambasadave: Do ta nxjerr ushtrinë për 30 qershor



TIRANË, 17 QERSHOR - Pasi i takoi të hënën paradite në Pallatin e Brigadave dhe diskutuan për më shumë se dy orë lidhur me krizën politike dhe veçanërisht për vendimin e tij për shtyrjen e zgjedhjeve, presidenti Ilir Meta u ka dërguar një letër ambasadorëve. Kreu i Shtetit në letër u tregon

ambasadorëve arsyen pse shtyu zgjedhjet dhe u ka treguar një memo mbi argumentet duke theksuar se shqiptarët nuk do të votojnë më 30 qershor. Në bisedën mes tyre, presidenti ka përsëritur të njëjtat motive për revokimin e datës së zgjedhjeve, madje duke ua kujtuar ambasadorëve se akti i

shkarkimit që ka ndërmarrë qeveria për të është një grusht shteti. Ndër të tjera, ai u ka komunikuar atyre në takim se më 30 qershor do ta nxjerrë në rrugë ushtrinë si Komandat i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nëse tentohet të bëhen zgjedhje. Sipas shp-

jegimeve të presidentit, atij i kanë ardhur informacione nga shërbime të huaja. Ndër të tjera, ai ka premtuar se do të tentojë t'i ulë në tryezë për të gjetur një zgjidhje, Ramën dhe Bashën, e nëse ia del, do ta kërkojë anulimin e protestës së opozitës parashikuar për t'u zhvilluar më 21 qershor.

Hahn: Nëse nuk çelen negociatat për Shqipërinë, rrezikohet perspektiva evropiane

TIRANË, 17 QERSHOR - Komisionari për Zgjerimin e Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, me të mbërritur në Luksemburg për mbledhjen e të Këshillit të Punëve të Jashtme, ka folur për gazetaret jashtë dyerve ku do të zhvillohet mbledhja, duke kërkuar fuqimisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian të bëjnë ç'është e mundur ta pranojnë çeljen e negociatave të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në BE.

Johannes Hahn, duke i dërguar një mesazh të qartë Parisit dhe Hagës, si dy vendet më skeptike për këtë proces, tha se nëse një hap i tillë nuk ndodh, do të vendoset në risk perspektiva evropiane e rajonit dhe, po ashtu, do të humbë besimi te këto vende se Komisioni Evropian mban premtimet. I pyetur se cili është mesazhi i tij për Parisin dhe Hagën, Hahn tha: "Mesazhi im për të gjithë është që ta kuptojnë situatën në rajon dhe

të gjithë perspektivën e tij, që një vend që ka bërë në mënyrë të jashtëzakonshme për perspektivën evropiane, që udhëheqja e këtij vendi që ka treguar kurajë dhe nëse nuk ia shpërblejmë këtë atëherë do të humbasim përgjegjësinë dhe besueshmërinë tonë. Çdo gjë që ne kemi investuar me sukses gjatë dy vjetëve të fundit ka rrezik që të shkojë kot nëse ne nuk do t'i mbajmë premtimet", tha Hahn.



Ministrat e Qeverisë së Kosovës kanë diskutuar të hënën me ambasadorët e vendeve të BE-së për gjetjet e raportit të Komisionit Evropian

Ministrat zotohen për kryerjen e punëve që dalin nga raporti i Komisionit Evropian



Disa nga ministrat e Qeverisë së Kosovës janë zotuar të hënën para ambasadorëve të vendeve të BE-së në Prishtinë se do t'i kryejnë të gjitha detyrat që dalin nga raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. Ata kanë treguar se pas publikimit të raportit për vendin kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm duke identifikuar të gjitha mangësitë, boshllëqet dhe rekomandimet e raportit për vendin dhe për t'ua përcjellë ato institucioneve përgjegjëse

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 SHKURT - Në takim me shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, dhe ambasadorët e vendeve të BE-së në Kosovë, ministrat e Qeverisë së Kosovës kanë diskutuar të hënën rreth raportit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Zyrtarët qeveritarë, para atyre të BE-së, janë zotuar se do t'i kryejnë të gjitha detyrat që dalin nga ky raport për të shënuar përparim. Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka deklaruar se për Kosovën procesi i integritimit evropian nuk është një alternativë, por është rruga që kemi zgjedhur. "Ne planifikojmë të mbajmë mbledhje mujore të Këshillit Ministror për Integrim

Evropian (KMIE) për të monitoruar zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve që rrjedhin nga raporti për vendin", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se institucionet duhet të reflektojnë për raportin dhe të vijnë me koordinimin më të mirë, bashkëpunimin dhe afate fikse ku nuk ka vonesa.

Raportin 2019 ajo e ka vlerësuar si avancim në procesin integruar, duke shtuar se dinamika e tij do të duhej përshpejtuar. Ajo i ka njoftuar të pranishmit se Ministria e Integritimit Evropian menjëherë pas publikimit të raportit për vendin kishte ndërmarrë hapat e nevojshëm duke identifikuar të gjitha mangësitë, boshllëqet dhe rekomandimet e raportit për vendin, duke ua përcjellë ato institucioneve përgjegjëse për veprime të mëtutjeshme

dhe të menjëhershme.

Po ashtu, Hoxha i ka njoftuar të pranishmit për takimin që kishte pasur me kryeministrin Haradinaj në formatin e takimit të Këshillit Ministror për Integritime Evropiane (KMIE) më 3 qershor 2019 për të diskutuar mbi të gjeturat dhe rekomandimet e raportit si dhe adresimin e tyre nga të gjitha institucionet e Kosovës.

Hoxha ka shprehur përkushtimin e saj për dinamizimin e mëtejshëm të procesit të integritimit evropian në të gjitha drejtimet e mundshme me qëllim të avancimit të mëtejshëm në këtë proces të paalternativë për Kosovën.

Edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, në këtë takim ka informuar për masat që po ndërmerr Ministria e Drejtësisë për adresimin e gjetjeve të

Raportit të Vendit të Komisionit Evropian. Sipas tij, raporti ka vlerësuar përparimin në reformat legislative dhe, po ashtu, hapat e ndërmarrë në konsolidimin e sistemit të drejtësisë. Përveç ndryshimeve normative, ministri Tahiri ka theksuar se raporti flet edhe për rritjen e numrit të stafit gjyqësor në prokurori dhe gjykata, përfshirë edhe në Prokurorinë Speciale. "Dëshiroj të theksoj se pas investimeve që kemi bërë në gjyqësor dhe sistemin prokurorial përmes rritjes së buxhetit për to, sot Republika e Kosovës ka arritur kuotat sipas standardeve evropiane për numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për kokë banori. Ky investim do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe presim një planifikim adekuat për nevojat e KGJK dhe KPK-së të cilat do t'i mbështesim vazhdimisht", ka thënë ministri Tahiri.

Sipas ministrit Tahiri, raporti vlerëson iniciativat e Ministrisë së Drejtësisë, Rishikimin Funkcional të Sundimit të Ligjit dhe Agjendën "Drejtësia 2020" si mekanizëm për koor-

dinimin institucional në funksion të zbatimit të ligjeve në fuqi.

Përveç ndryshimeve të bëra në Shërbimin Korrektues dhe Sprovues, Tahiri ka përmendur edhe ndryshimet që po bëhen në legjislacionin dhe mekanizmat e luftës kundër korrupsionit. "Lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar nuk është proces që duhet të matet me një numër të thjeshtë rastesh të shënjestruara, por duhet të vazhdojë të prodhojë rezultate të përgjithshme në secilin drejtim dhe mendoj se kemi ende shumë punë për të bërë që të arrijmë rezultate më të mëdha në këtë drejtim. Por ajo çfarë është e sigurt është se sot, pas miratimit të reformave legjislative, organet e pavarura të zbatimit të ligjit kanë në duar instrumente të fuqishme për ta goditur korrupsionin dhe krimin e organizuar në një nivel krejt tjetër nga ajo çfarë është dëshmuar deri më sot", ka thënë ministri Tahiri.

Në këtë takim ka marrë pjesë edhe ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa.

LDK-ja merr vendim për Degën III në Prishtinë: Abrashi dhe Borovci tërhiqen nga gara

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), e udhëhequr nga kryetari Isa Mustafa, sot ka mbajtur një takim. Mes të tjerash, analizozi edhe situatën e krijuar në disa degë të LDK-së gjatë procesit zgjedhor. Thëks i veçantë u është kushtuar zhvillimeve të fundit në Degën

III në Prishtinë, me ç'rast kryesia rithekson se sjelljet e dhunshme dhe pamjet e tilla janë mënyra dhe metoda të papranueshme për LDK-në. Duke analizuar situatën e krijuar, kryesia e LDK-së mori vendim që Hazir Borovci dhe Arban Abrashi, të përmendur në terren për

kryetar të Degës III në Prishtinë, të tërhiqen nga gara për kryetar të Degës, me qëllim që t'i kthehet normaliteti procesit të zgjedhjeve brenda LDK-së. Është bërë me dije se pjesën e mbetur të procesit zgjedhor në Degën III do ta udhëheqë kryesia qendrore e LDK-së.



Flet për "Epokën e re", Besnik Tahiri

Ligji për qeverinë do të mi



- Qeveria nuk do të ketë më shumë se 15 ministri, 30 zëvendësministra si dhe nuk do të ketë zëvendëskryeministra pa portofol

Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se gjatë këtij viti do të miratohet Ligji për qeverinë. Ai ka thënë se me këtë ligj qeveria nuk do të ketë më shumë se 15 ministri, 30 zëvendësministra si dhe nuk do të ketë zëvendëskryeministra pa portofol. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka deklaruar se ky ligj përmirëson efikasitetin dhe funksionalitetin e ekzekutivit. Duke folur për reformën shtetërore, ai ka thënë se nuk ka reformë e cila nuk është e dhimbshme. Megjithatë, Tahiri ka vlerësuar se reforma mund të jetë në disfavor të partive që udhëheqin qeverinë, por gjithmonë është e pëlqyer nga shoqëria. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës reformën në administratën shtetërore e ka vendosur në prioritetin kryesor

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 QERSHOR - "Epoka e re": Z. Tahiri, si po ecën procesi i reformës shtetërore në Republikën e Kosovës?

Tahiri: Qeveria e Republikës së Kosovës reformën në administratën shtetërore e ka vendosur në prioritetin kryesor. Vitin e kaluar është miratuar pakaja e ligjeve që e rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës së shtetit dhe agjencive ekzekutive, pra që e disiplinon dhe e rregullon me model evropian. Derisa nuk është aprovuar Ligji për pagat, organizatat buxhetore në një

farë forme kanë bërë rritjen e pagave dhe kanë riorganizuar sistemin e pagave në bazë të një organizimi të tyre, kurse tani secili shërbyes i shtetit që nga presidenti e deri te punëtori teknik është i normuar në tabelë dhe saktësisht e di sa e ka pagën. Kemi miratuar edhe Ligjin për zyrtarët publikë i cili i përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet e modeleve evropiane dhe njëkohësisht shërbyesin publik e kthen në një shërbyes për qytetarë duke e sanksionuar për çdo aktivitet tjetër si politik ashtu edhe të aspekteve të tjera. Ky ligj kur të hyjë në fuqi do t'u mundësojë njerëzve që përmes testit dhe përmes procesit të testimit të jenë të barabartë në

Miratohet strategjia për rini

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar të hënën Strategjinë e Rinisë 2019-2023. Dokumenti strategjik trajton shqetësimet e kohës së sotme të të rinjve nga mosha 15-24 vjeç dhe politikat ndërsektoriale në përputhje me legjislacionin në fuqi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se duke pasur parasysh nevojat e mëtejme dhe realizimin e kërkesave nga të rinjtë, si dhe paraqitjen e kërkesave në rrethana të reja

lidhur me zhvillimet e sotme rinore në Kosovë, ndihet një nevojë e theksuar për ta vazhduar rrugën e përkrahjes së rinisë. "Kjo është strategji gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ka për synim përmirësimin e situatës së të rinjve të grupmoshave 15-24 vjeç, duke përfshirë të gjitha palët e interesit si nga sektori qeveritar, po ashtu edhe nga ai joqeveritar dhe, poashtu, ta nxisë edhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, veprimtaria e të cilave lidhet me rininë, si dhe

ndërmjet organizmave qendrorë dhe atyre komunalë për t'i fuqizuar politikat dhe programet rinore", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se qëllimi kryesor është ideja e përafrimit të të rinjve kosovarë me parimet dhe praktikatat më të mira evropiane, në veçanti me nevojat që i ka rinia në vendin tonë. Ai ka shtuar se ky dokument strategjik do të jetë një mundësi për rininë në Kosovë që të jetë edhe më aktive dhe më kërkuese dhe, në anën tjetër, të jetë pjesëmarrëse dhe vendim-marrëse në proceset në Kosovë.



ratohet këtë vit

përpilimin e politikëbërjes, do të thotë ta ngrehim kapacitetin te shërbyesit e lartë civilë.

"Epoka e re": Në përgjithësi, cilat janë vështirësitë me të cilat po ballafaqohet procesi i reformës shtetërore?

Tahiri: Nuk ka reformë shtetërore e cila nuk është e dhimbshme. Reforma realisht mundet me qenë në disfavor të partive që udhëheqin qeverinë, por gjithmonë është e pëlqyer nga shoqëria. Si shef i reformës shtetërore kam pasur një mbështetje të fuqishme nga kryeministri Haradinaj, nga kryeparlamentari Veseli, zëvendëskryeministri Limaj dhe zëvendëskryeministri Pacolli. Realisht unë i kam bërë më tepër aspektet e modelimit dhe aspektet e rregullimit teknik në vijë me mandatin, por edhe me vlerat e qeverisjes së mirë. Më vjen mirë që raporti i Komisionit Evropian e ka vlerësuar lart dhe shumë saktë punën që ka bërë qeveria sa iu përket reformave shtetërore. Një sfidë me të cilën jemi duke u ballafaquar është hartimi i disa rregulloreve që duhet të dalin nga këto ligje, grupet punuese janë themeluar, një numër i tyre janë në proces dhe katër prej tyre i kemi përmbyllur. Në këtë proces mendoj se jemi në rrugë të drejtë dhe pastaj do të vijë Ligji për qeverinë, Ligji për racionalizimin dhe organizimin e agjencive ekzekutive, Ligji për financat lokale dhe të tjera.

"Epoka e re": Cili është suksesi kryesor i këtij procesi?

Tahiri: Viti 2018 ka qenë vit i hartimit dhe miratimit të legjislacionit bazë për reforma, kurse viti 2019 është vit i jetësimit të reformave si me miratimin e Ligjit për paga, Ligjit për zyrtarët publikë dhe Ligjit për organizimin e administratës shtetërore, po ashtu edhe me miratimin e Ligjit për qeverinë dhe Ligjin për racionalizimin dhe organizimin e agjencive ekzekutive dhe, mbi të gjitha, me praktikën e mira që i kemi vendosur në procesin e performancës dhe rekrutimit.

"Epoka e re": Kur do të miratohet Ligji për qeverinë?

Tahiri: Ligji për qeverinë është gati. Aktualisht jemi në konsultim të brendshëm. Tash po e trajtojmë me juristë dhe profesionistë sanksionimin e numrit të dikastereve qeveritare në kuadër të këtij ligji. Pastaj ligji do të dalë në diskutim publik dhe shumë shpejt besoj do të miratohet në qeveri, pastaj të procedohet në Kuvend. Ligji për qeverinë e përcjell logjikën e modeleve ndërkombëtare të ministrive kryesore. Do të thotë,

kemi bërë një analizë krahasuese të vendeve evropiane që janë të ngjashme me Kosovën dhe kanë dalë nëntë ministri më kryesore dhe jemi duke i organizuar dikasteret në mënyrë që Qeveria e Republikës së Kosovës mos të ketë më shumë se 15 ministri. Me këtë ligj qeveria do të ketë jo më shumë se dy zëvendësministra dhe secili zëvendësministër do ta ketë detyrën e vet të sanksionuar si dhe do të ketë zëvendëskryeministra me portofol, pra nuk do të ketë zëvendëskryeministra pa portofol. Përveç kësaj, në Ligjin për qeverinë i kemi identifikuar të metat përgjatë viteve të cilat i kemi sanksionuar me nene duke e penguar potencialisht keqpërdorimin e detyrës zyrtare e cila do të mund të ndodhte në mungesë të një ligji të saktë. Ndër vite kemi pasur një numër të madh të lëvizjeve sa i përket numrit të ministrive dhe kemi parë se në mungesë të një ligji rregullorët kanë ndryshuar hap pas hapi.

"Epoka e re": Përveç zvogëlimit të numrit të ministrive, çka parasheh tjetër ky ligj?

Tahiri: Ky ligj në radhë të parë e parandalon ushtrimin e funksioneve të tjera të kryeministrit dhe ministrave. E parandalon vendimmarrjen në kohë të fushatave zgjedhore, pastaj deri në esencë e shpjegon procesin e konsultimit dhe transparencës dhe, mbi të gjitha, e vendos tavanin, respektivisht e saktëson numrin e ministrive, të zëvendësministrave dhe e riorganizon portofolin në bazë të sektorëve të vet. Për shembull, aktualisht ka shumë ministri që merren me ekonominë, kurse me këtë ligj do të jetë një ministri që do ta ketë sektorin e ekonomisë, tregtisë, investimeve strategjike dhe kështu me radhë. Ky ligj përmirëson efikasitetin dhe funksionalitetin e ekzekutivit.

"Epoka e re": Z. Tahiri, përfundimisht brenda këtij viti Kosova do ta ketë Ligjin për qeverinë?

Tahiri: Unë pres që ky ligj të miratohet këtë vit. 2019 Kosovën do ta gjejë me Ligjin për qeverinë i cili do të jetë model edhe për rajonin. Me këtë rast i falënderoj të gjithë ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë qenë pjesë e procesit të hartimit të këtyre ligjeve, në veçanti të Ligjit për qeverinë. Ligji për qeverinë do të duhet të merrte 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës sepse është ligj që u përshtatet të gjithëve.

Bytyqi: Kosovës i duhen drejtorë të mirë të shkollave



PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, mori pjesë të hënën në ceremoninë e hapjes së punimeve të konferencës dyditore "Nga paqja në prosperitet - transformimi i shoqërisë kosovare përmes lidërshiptit të mirë", e cila po mbahet në Prishtinë.

Në këtë konferencë të organizuar nga MASHT-i dhe Fondacioni Kosovar i Lidërshiptit, po marrin pjesë ekspertë dhe udhëheqës vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe udhëheqës dhe mesimdhënës të dy universiteteve të njohura amerikane:

Universitetit "James Madison" dhe "Mercer".

Ministri Bytyqi këtë konferencë e ka vlerësuar shumë të rëndësishme, ndërsa ka thënë se lidërshipti dhe një udhëheqës i mirë është me rëndësi të veçantë për secilin dikaster dhe secilën fushë. Ai ka thënë se Kosovës i duhen drejtorë të mirë të shkollave, rektorë të universiteteve e kolegjeve që bëjnë gara për të qenë më të mirët, por edhe udhëheqës të mirë brenda ministrisë që hartojnë politika të mira dhe të sigurt, dhe në këtë mënyrë ua lehtësojnë punën edhe udhëheqësve në institucionet e arsimit.

Në FSK përfundon 'Kampi Rinor 2019'



MITROVICË, 17 QERSHOR (ER) - Në Komandën e Batalionit të Dytë të Brigadës së Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë është mbajtur ceremonia e certifikimit të nxënësve të shkollave të mesme të Kosovës, të cilët për një javë rresht ishin pjesë e "Kampit Rinor 2019".

Organizimi i "Kampit Rinor 2019" ka për qëllim që nxënësit e shkollave të mesme të njihen me jetën ushtarake dhe të familjarizohen sa më shumë me unifor-

mën në mënyrë që në të ardhmen të mos hezitojnë, por të bëhen pjesë e kësaj jete.

Gjatë javës së qëndrimit në kamp nxënësit kanë ndjekur ligjëratat dhe trajnim të ndryshme si: zgjimi dhe rregullimi i shtretërve, gjimnastika e mëngjesit dhe higjiena personale, UÇK, TMK-transformimi, orientimi në natyrë, mësimi i komandave, misioni, detyrat dhe struktura e FSK-së, vetëdijësimi nga minat, kërkim-shpëtimi etj.

procesin e rekrutimit. Pra, më nuk do të ketë intervistime me panele një me një, mirëpo do të ketë test dhe 90 për qind e vlerësimit do të ndodhë mbi bazën e meritës dhe jo mbi baza të tjera.

"Epoka e re": Edhe më tutje shteti i Kosovës vazhdon ta ketë një administratë të politizuar dhe jo shumë efikase. Kjo çështje është përmendur nga viti në vit në raportet për Kosovën të Komisionit Evropian. Çfarë do të bëni për ta depolitizuar administratën dhe për ta bërë më funksionale?

Tahiri: Do t'i ndërmarrim një serë çështjesh në këtë drejtim. Administrata Shtetërore e Kosovës nuk është në numra të mëdhenj ashtu siç flitet. Edhe në bazë të popullsisë dhe aspekteve të tjera administrata shtetërore e Kosovës është shumë më përpara se ato të vendeve të rajonit. Është e vërtetë se në administratën e shtetit përgjatë viteve ka pasur ndikim politik dhe këtë ne jemi duke e përmirësuar. Aktivitetet politike për shërbyes civilë me këtë ligj sanksionohen saktë dhe mbi këtë bazë në sistemin e rekrutimit do të vendoset meritokracia. Në anën tjetër, shërbyesit civilë në masë të madhe kanë arritur ta ngritin kapacitetin e tyre, mirëpo duhet ende të punohet në veçanti në

Përkujtohet veterani i luftës së UÇK-së dhe babai i tre heronjve, Hilmi Haradinaj

EPOKA E RE Qendresa RAMA

GLLOGJAN, 17 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë të hënën homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan, në njëvjetorin e vdekjes së veteranit të luftës së UÇK-së, Hilmi Haradinaj, baba i tre heronjve të kombit.

Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Haradinaj tha se sot është një ditë e kujtimit të ndarjes nga jeta e babës Hilmi, duke falën-

deruar të gjithë ata që përgjatë gjithë jetës, sa ishte gjallë Hilmi, i bën nderim dhe respekt nga të gjitha trojet e atdheut. "Një falënderim i madh u shkon të gjithë atyre që morën pjesë në varrim. Edhe sot ju falënderoj për idenë për ta kujtuar Hilmin në njëvjetorin e ndarjes nga jeta", tha kryeministri Haradinaj, duke theksuar se nuk është i tepërt nderimi për figurat e kombit, bashkëluftëtarë, veprimtarë e dijetarë.

Kryeministri Haradinaj tha se kësaj "dërgojmë porosi se kemi një vetëdije të lartë kombëtare e cila nuk është e rastësishme, ashtu

siç nuk është e rastësishme liria e Kosovës si pjesë e lirisë së atdheut". "Kjo është një porosi për ata që jetojnë në Kosovë, si për shumicën shqiptare, komunitetet, por edhe për palët e tjera, se ata që dinë ta respektojnë Kosovën dhe të drejtën e saj, Kosova është mirënjohëse", tha kryeministri Haradinaj.

Para të pranishmëve të shumtë, përfaqësuesve të shumtë të nivelit qendror dhe lokal, një fjalë rasti e mbajti kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, i cili tha sot po e kujtojnë një burrë të madh të kombit.



Për dy vjet, tetë raste të vdekjeve në burgjet e Kosovës

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Brenda dy vjetësh, sipas të dhënave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, tetë persona kanë vdekur nëpër burgje derisa po e vuanin dënimin. Përfshirë një rast i cili po hetohet, vdekjet e tjera, sipas përfaqësuesve të këtij Shërbimi, kanë ardhur si pasojë e sëmundjeve prej të cilave ata vuanin dhe se asnjë nga rastet nuk cilësohet vdekje e dyshimtë.

Florent Gashi, zyrtar për informim në Shërbimin Korrektues të Kosovës, tha për "Radion Evropa e Lirë" se të burgosurit të cilët kanë vdekur brenda burgjeve të Kosovës, kryesisht vuanin nga sëmundje të rënda. "Gjatë dy vjetëve të fundit nëpër burgjet e Kosovës kanë vdekur gjithsej tetë



persona. Vdekjet kanë ardhur si pasojë e sëmundjeve të tyre (të të burgosurve). Kryesisht po vuanin nga sëmundje të rënda si kanceri, sëmundje të zemrës, sëmundje infektive etj. Nga këto raste, vetëm rasti i fundit, i cili ka ndodhur ditën e premte, më datë 14 qershor, po

hetohet nga organet kompetente. Rastet e tjera janë konfirmuar si vdekje jo të dyshimta", ka thënë Gashi.

Rasti i fundit i vdekjes së një të burgosuri ka ndodhur javën e kaluar në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Ai ishte i lindur në vitin

1992, shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe akuzohej për veprën penale: blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve. I burgosuri, me rekomandim të mjekut të Qendrës Korrektuese në Dubravë, ishte dërguar me urgjencë në Spitalin Rajonal të Pejës, por edhe përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore, ka ndërruar jetë, ka njoftuar Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Përfaqësues të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) flasin për shërbime joadekuate mjekësore brenda burgjeve të Kosovës. Kryetari i KMDLNJ-së, Behxhet Shala, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se çdo vdekje e të

burgosurve në burgje paraqet shqetësim dhe se shteti duhet ta ketë obligim mbrojtjen e shëndetit të tyre.

Një nga rastet e dyshimta të vdekjes në burg ishte rasti i Astrit Deharit në gusht të vitit 2016. Ish-aktivisti i Vetëvendosjes, Astrit Dehari, ka vdekur teksa mbahej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, nën dyshimin për pjesëmarrje në sulmin ndaj ndërtesës së Kuvendit të Kosovës. Familjarët e Astrit Deharit, por edhe Lëvizja Vetëvendosje, nuk janë pajtuar me gjetjet e institucioneve vendore lidhur me këtë rast, të cilat kanë konstatuar se Dehari është vetëvrarë.

Familja ka dërguar superekspertizë në një institucion në Zvicër.

Maria Suokko merr detyrën si përfaqësuese e përhershme e UNDP-së në Kosovë



PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Maria Suokko (Finlandë) është emëruar Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së në Kosovë dhe ka filluar punën të hënën. Ajo zëvendëson në këtë pozitë Alessandra Roccasalvo, e cila ka qenë në këtë detyrë nga 1 janari 2019-s. Para emërimit në këtë detyrë, Suokko ishte këshilltare e lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Finlandës në Helsinki që nga shtatori 2017. Ajo shërbeu si

udhëheqëse për bashkëpunim pranë MPJ të Finlandës në Myanmar (2014-2017) dhe këshilltare e lartë në MPJ të Finlandës (2012-2014).

Përvoja e saj me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) përfshin postin e specialistes të Programit në Byronë Rajonale për Azi dhe Paqësor (2006-2010), ndihmëspërfaqësuese e përhershme në UNDP Kinë (2001-2005),

menaxhere e Programit Mjedisor të UNDP-së në Kamboxhia (2000-2001) dhe zyrtare e Programit në UNDP Tajlandë (1998-2000).

Ajo ka një diplomë master në shkencën sociale (Ekonomi) nga Universiteti i Helsinkit. Pas emërimit të saj përfaqësuese e përhershme në Zyrën e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko ka thënë se e ka marrë këtë detyrë në një moment shumë të rëndësishëm, pasi Zyra e UNDP-së po shënon

20-vjetorin e bashkëpunimit të suksesshëm në Kosovë. "Me padurim pres që t'i takoj të gjithë partnerët tanë kosovarë dhe ndërkombëtarë dhe t'i vazhdojmë përpjekjet tona të përbashkëta për mbështetjen e rrugës së zhvillimit që do të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë", ka thënë Suokko. Përveç gjuhës finlandeze, Maria flet anglisht, suedisht, si dhe, deri në një masë, frëngjisht dhe gjermanisht.

ZKA-ja publikon edhe 37 raporte të auditimit të rregullsisë për vitin financiar 2018

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar edhe 37 raporte të auditimit të rregullsisë për vitin financiar 2018. Zyra Kombëtare e Auditimit ka njoftuar se deri më tani janë publikuar 73 raporte, ndërsa deri në fund të muajt qershor do të publikohen 115 raporte të rregullsisë, prej tyre: 94 raporte të organizatave buxhetore,

prej tyre 26 institucione të nivelit qendror, 30 institucione të pavarura dhe 38 të nivelit lokal (komunat); 12 raporte të ndërmarrjeve publike; 9 raporte të auditimit të projekteve (të financuara nga donatorët). "Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike, rrisin besimin në

shpenzimin e fondeve publike dhe luajnë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve të tjera të interesit për rritjen e përgjegjësisë së organizatave buxhetore për menaxhim të mirë të fondeve publike", është thënë në njoftimin për media.

Zyra Kombëtare e Auditimit auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të

të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA, po ashtu, kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe ofrimit të tyre me kosto efektive.



Procesi i auditimit kryhet në bazë të kornizës ligjore në vend dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit dhe praktikave të mira evropiane.

Fillon Java e Shëndetësisë Kosovë - Turqi, synohet rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka filluar Java e Shëndetësisë Kosovë - Turqi 2019 e cila organizohet për të gjashtin vit me radhë. Në kuadër të kësaj jave, 26 profesionistë shëndetësorë nga Turqia, në bashkëpunim edhe me mjekët nga QKUK-ja, do të kryejnë operacione të ndërlikuara dhe do të mbajnë ligjërata në kuadër të edukimit profesional të stafit në klinika të ndryshme.

Hapjen e ka bërë dr. Naim Bardiqi, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ka theksuar se organizimi i Javës së Shëndetësisë Kosovë - Turqi 2019 bëhet në kuadër të marrëveshjes së përgjithshme që kanë Republika e Kosovës dhe Republika e Turqisë për mbështetje të shëndetësisë së Kosovës. Sekretari Bardiqi ka pohuar se tashmë është bërë traditë organizimi i kësaj jave, e cila do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe edukimin e stafit shëndetësor.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se kjo javë organizohet në kuadër të përpjekjeve për ta rritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore, por edhe për të ndikuar në edukim profesional të stafit. Ministri ka falënderuar shtetin turk dhe Ambasadën e Turqisë në Kosovë të cilët kanë ndihmuar në organizimin e kësaj

jave, duke shtuar se në dekadat e fundit Turqia ka bërë reforma tejet të mëdha në shëndetësi, andaj kjo do të ndihmojë që reformat të jenë të prekshme edhe në Kosovë, duke ndikuar në përfitim e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe edukimin e stafit. "26 persona të ndryshëm, profesionistët të ndryshëm nga Turqia, do të shpërndahen në klinika të ndryshme dhe për një javë, me profesionistë të Kosovës, do t'i shkëmbejnë përvojat", u shpreh ai. Çagri Sakar, ambasador i Republikës së Turqisë në Kosovë, ka thënë se Java e Shëndetësisë Kosovë - Turqi do të organizohet nga data 15 deri më 23 qershor, organizim ky që bëhet në kuadër të politikave të jashtme humanitare që ka shteti i Turqisë. "Në kuadër të politikës së jashtme dhe humanitare për zhvillimin e shëndetësisë, për ta ndarë përvojën tonë, ne kemi organizuar në tri kontinente të ndryshme, ku kemi kryer 25 mijë operacione, me gjithsej 45 javë të shëndetësisë në vendet e ndryshme", ka thënë Sakar.

Ambasadori rikujtoi se vitin e kaluar, në kuadër të javës së shëndetësisë Kosovë - Turqi, ishin kryer 396 operacione, 1 329 trajtime dhe 1 256 punëtorë shëndetësorë kishin ndjekur trajnime.

Dr. Basri Sejdiu, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, u shpreh i kënaqur me organizimin e bashkëpunimit me mjekët nga Turqia, duke shtuar se në këtë rast



më së shumti përfitojnë pacientët që do të marrin shërbime shëndetësore, por edhe në edukimin e stafit shëndetësor. "Pacientët do të përfitojnë më së shumti, sepse ata do të marrin shërbime, krahas mjeteve dhe pajisjeve që na kanë sjellë, po ashtu edhe edukim të stafit përmes shkëmbimit të përvojave. Ky mision është vazhdimësi e bashkëpunimit që ka kontribuar mjaft në shëndetësinë e Kosovës", ka thënë drejtori Sejdiu.

Ndërsa Arif Çetin, drejtor i

Drejtorisë për Çështje Ndërkombëtare dhe BE-së në Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Turqisë, ka theksuar se Turqia ka marrëveshje për përkrahje të shëndetësisë së Kosovës nga viti 2009. "Në kuadër të saj po organizohet kjo javë, por edhe bëhet i mundur trajtimi falas i 100 pacientëve nga Kosova në Turqi. Po ashtu janë bërë marrëveshje për trajnime të stafit mjekësor", është shprehur Çetin. Ekipi mjekësor nga Turqia ka në përbërje: urologë, gjinekologë,

oftalmologë, kirurgë pediatrikë, ortopedë me traumatologë, kardiologë të fëmijëve dhe të rriturve, kardiokirurgë për fëmijë dhe të rritur, specialistë të sëmundjeve infektive, radiologë, specialistë të shëndetit dhe të sëmundjeve të fëmijëve dhe të sëmundjeve të brendshme. Përfaqësues të mjekëve nga Turqia thanë se në Kosovë do t'i praktikojnë pjesët më modern të mjekësisë, me pajisje dhe mjete që janë më të zhvilluarat në spitalet e Turqisë.

Shoqëria civile marshoi kundër Projektligjit për financimin e subjekteve politike

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Mbi 100 organizata të shoqërisë civile i janë bashkuar të hënën "Marshit të refuzimit" për ta kundërshtuar Projektligjin për financimin e subjekteve politike. Marshi nisi nga Sheshi "Skënderbeu" dhe vazhdoi me ndalje në selitë e gjashtë partive më të mëdha parlamentare, por përfaqësuesit e shoqërisë civile u penguan në mënyrë të dhunshme nga punonjës të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) para selisë së kësaj partie në Prishtinë, përkundër faktit se për këtë marsh ishin të informuara të gjitha institucionet relevante, duke përfshirë edhe PDK-në.

Shoqëria civile dënon dhunën e ushtruar ndaj pjesëtarëve të organizatave joqeveritare dhe i bënë thirrje PDK-së, që si subjekti më i madh në koalicionin aktual qeverisës, ta marrë barrën e përgjegjësisë që u takon dhe me veprimet e tyre të kontribuojnë

në ndërtimin e shtetit, duke respektuar standardet e shoqërive demokratike dhe të drejtën elementare për bashkim qytetar, shprehje të lirë dhe protesta të qeta.

Shoqëria civile kërkon qëndrim dhe masa të veprimit nga PDK-ja për veprimet e dhunshme të stafit të saj. Marshi kishte për qëllim kundërshtimin e miratimit të Projektligjit për financimin e subjekteve politike i cili është në kundërshtim me frymën kushtetuese, cenon standardet ndërkombëtare për financimin e partive politike, në veçanti rekomandimet e Komisionit të Venedikut.

Përfaqësues të shoqërisë civile përmes mesazheve të qarta që i vendosën në selitë e partive politike u rekomanduan atyre që ta refuzojnë këtë projektligj, i cili shpenzon taksat e qytetarëve pa llogaridhënie, bën pazare politike me paratë publike, fsheh emrat e donatorëve të partive, prejardhjen e mjeteve financiare dhe ul tarifën e gjobave.



Konkretisht, amendamentet e miratuara në lexim të dytë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e dëmtojnë projektligjin sepse: cenojnë pavarësinë e Zyrës për Regjistrimin e Subjekteve Politike duke ia hequr kësaj zyre mandatin për mbikëqyrjen e financave të partive politike, përfshirë shqiptimin e gjobave. Bartja e këtyre funksioneve në një

trup politik si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) bie ndesh edhe me rekomandimet e Komisionit të Venedikut për forcimin e rolit të Zyrës. Nuk adresojnë prioritetet e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) për të siguruar transparencë, llogaridhënie, zbatim dhe sanksione efikase në financimin e partive politike. Programi Kombëtar për

zbatimin e MSA-së 2019-2023 e thotë qartë se KQZ-ja nuk duhet të jetë autoritet i kontrollit të financave të partive politike; dëmtojnë frymën kushtetuese të ligjit për shkak të dispozitave kontradiktore që rregullojnë marrëdhënien midis subjektit politik dhe deputetit për çështjen e fondit; cenojnë transparencën e subjekteve politike ndaj publikut pasi që mundësojnë mospublikimin e emrave të pronarëve të personave juridikë (kompanive) që japin kontribut për subjektet politike. Për më tepër, tavanet e kontributeve "në para të gatshme" për subjektet politike janë dhjetëfishuar (nga 50 në 500 euro), ndërsa kontributet e personave fizikë dhe juridikë në kohë fushate janë dyfishuar; zvogëlojnë llogaridhënie e subjekteve politike ndaj publikut pasi që lejon zgjatje të afateve për publikim të raporteve financiare të fushatës. Po ashtu, gjobat për shkeljet e dispozitave ligjore nga subjektet politike janë zvogëluar deri në 75 për qind.

Guvernatori Mehmeti: Sistemi financiar në Kosovë ka pasur zhvillime pozitive

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka takuar të hënën zyrtarët e misionit të Bankës të Bankës Botërore, të cilët po qëndrojnë për vizitë në Kosovë. Në këtë takim u diskutuan detajet e angazhimit për komponentin zhvillimor të FSAP-s sa i përket sistemit të pagesave, identifikimit të hendekut të financimit dhe çështje të tjera zhvillimore për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Guvernatori Mehmeti i ka informuar zyrtarët e këtij institucioni lidhur me pozicionin e

sistemit financiar në vend dhe ka falënderuar përfaqësuesit e Bankës Botërore për përkrahjen e vazhdueshme që Banka Botërore ka dhënë dhe në vazhdimësi po jep për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka deklaruar se sistemi financiar në Republikën e Kosovës ka pasur zhvillime pozitive në të gjithë indikatorët e tij, me një rritje vjetore të kreditimit prej 11 përqindësh rritje vjetore të depozitave prej rreth 10 përqindësh, normat e interesit në kredi kanë zbritur në 6.5 përqind, ndërsa norma e kredive



joperformuese ka shënuar rënie në 2.6 përqind.

Guvernatori Mehmeti i ka njoftuar përfaqësuesit e BB-së lidhur me zhvillimet pozitive në sektorët e tjerë, si në sektorin e sigurimeve, pensione dhe atë

të institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare. Përfaqësuesit e BB-së, të kryesuar nga shefi i misionit Nadeem Karmali, falënderuan guvernatorin Mehmeti për bashkëpunimin e vazhdueshëm

dhe e përgëzuan BQK-në për iniciativat zhvillimore në funksion të zhvillimit të BQK-së si dhe diskutuan për mënyrat e rritjes së mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet BB-së dhe BQK-së.

Lansohet edicioni i dytë i Fondit të Inovacionit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-i gjerman kanë lansuar të hënën edicionin e dytë të Fondit të Inovacionit, pjesë e Projektit CETEP, i cili implementohet nga Innovation Centre Kosovo (ICK). Npërmjet këtij fondi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund përfitojnë deri në 50 000 euro.

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka thënë se edicioni i dytë i Fondit të Inovacionit ofron përkrahje të drejtpërdrejtë dhe më të madhe



për sektorin privat. Sipas tij, krahas ndihmës financiare, duhet të ndërtohen edhe mekanizma për të garantuar zhvillim të

qëndrueshëm. "Ne dhe GIZ-i kemi ndërtuar një partneritet strategjik, pasi që kemi vizionin dhe besimin e njëjtë, se vendi ynë

ka potencial për avancim të mëtutjeshëm të sektorit të prodhimit dhe TIK-ut", ka thënë ministri Beqaj.

Ai ka theksuar se qëllimi i Fondit të Inovacionit është zhvillimi i kompanive dhe përkrahja e eksporteve. "Ky është edicioni i dytë i Fondit të Inovacionit. Vitin e kaluar kemi financuar, bazuar në ekspertizën e pavarur të vlerësimit, pesë kompani të suksesshme, tek të cilat kemi arritur të ndikojmë drejtpërdrejt në promovimin e tyre në tregjet ndërkombëtare", ka deklaruar ministri Beqaj.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, sipas tij, do t'i

mbulojë rreziqet nga investimet e ideve të ndërmarrësve të rinj. "E rëndësishme është që të mos dorëzoheni në planet tuaja për të krijuar vende pune, për të prodhuar, për t'i përmirësuar shërbimet, për të eksportuar. Nxitja e shpirtit ndërmarrës na ndihmon shumë për arritjen e objektivave dhe përballje me sfidat nëpër të cilat po kalon e gjithë bota", ka theksuar ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Fondi i Inovacionit është bashkë-financim i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe GIZ-it, nëpërmjet Projektit CETEP i cili implementohet nga ICK-ja.

ATK-ja, pjesë e samitit të stabilitetit financiar dhe monetar në rajon



PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Nga data 13 deri më 15 qershor në Beçiq është mbajtur samiti rajonal me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, në një klimë të rritjes së ngadalshme në Eurozonë" i guvernatorëve, ministrave të financave dhe drejtorëve të administratave tatimore. Pjesëmarrës në këtë samit ishin përfaqësues nga shtetet rajonale, si: Kosova, Mali i Zi,

Shqipëria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia.

Në panelin e Drejtorëve të Administratave Tatimore temë diskutimi ishte "Reforma e autoriteteve tatimore dhe lufta kundër ekonomisë së hirtë", në të cilin ishte drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj.

Në këtë samit drejtori Murtezaj ka prezantuar të arriturat e ATK-

së në funksion të përmbushjes tatimore, si dhe në luftimin e dukurive të ekonomisë joformale si njëra nga rreziqet kyçe të konkurrencës së drejtë në biznes.

- Takođe obavlja i druge poslove na zahtev svojih nadređenih;
- Za svoj rad odgovara Zakonu, svom Pretpostavljenom-Inženjeru, Izvršnom Šefu.

Radno mesto: Tehnički Radnik-Centralno grejanje referentni broj 15/2019

Sprema i stručne sposobnosti:

- Diploma srednje Tehničke škole;
- Prednost obrazovanje - Certifikat iz oblasti Centralnog Grejanja;
- Poželjno poznavanje principa rada konkretnih sistema (HVAC) ili slično;
- Poželjna starost: 18 - 45 godina
- Da je spreman za rad u ekipi i samostalno;
- Dokazati sposobnost stvaranja dobrih radnih odnosa unutar i izvan preduzeća;
- Visok nivo motivacije, inicijative i pažnje u detaljima;
- Visok nivo stručne etike.

Glavne odgovornosti su:

- Nosioc poslova, obavlja poslove mehaničkog održavanja vodovoda, kanalizacije, cevovoda centralnog grejanja i vrši servisiranje prema zahtevima inženjera;
- Poštuje uputstva za održavanje koja su projektovana od strane inženjera;
- Uz konsultaciju sa svojim pretpostavljenim, obavlja preventivne radove na održavanju vodovoda, kanalizacije i sistema centralnog grejanja, prema potrebama i zahtevima;
- Interveniše u popravkama u slučaju kvarova u sistemu cevovoda u celini;
- Svaki put odgovara na poziv za intervenciju i nastavlja da radi prema zahtevu;
- Primenjuje sva pravila o ličnoj sigurnosti;
- Takođe obavlja i druge poslove na zahtev svojih nadređenih;
- Za svoj rad odgovara Zakonu, svom Pretpostavljenom-Inženjeru, Izvršnom Šefu.

Radno mesto: Održavaoc Spoljne površine referentni broj 16/2019

Sprema i stručne sposobnosti:

- Diploma srednje škole;
- Da je predan poslu;
- Dobra sposobnost komunikacije;
- Da je spreman za rad u ekipi i samostalno;
- Visok nivo stručne etike.

Glavne odgovornosti su:

- Stara se o čistoći vanjskih površina centra;
- Vršiti održavanje zelenih površina centra;
- Odgovara na svaki poziv prema potrebi naručitelja usluga za rad prema potrebi u objektu preduzeća;
- Blagovremeno obaveštava naručioca usluga o nedostatku opreme i higijensko-sanitarnog materijala;
- Za svoj rad odgovara svom Pretpostavljenom.
- Kao i druge usluge koje proizlaze iz prirode higijenskog održavanja koje zahteva pretpostavljeni.

Procedura prijavljivanja:

- Aplikacija za posao
- CV
- Dokaz o stručnoj spremi
- Izvod iz matične knjige rođenih (original)
- Lična karta (kopija)
- Radno iskustvo iz stručne oblasti (za pozicije gde je neophodno)
- Potvrda da nije pod istragom i potvrda da nemate krivični dosije.

napomenae: Svu dokumentaciju preuzimate u administraciji Qendra Multifunkcionalne, kao i da trebate da je dostavite u zatvorenoj kovrti.

Dostavljena dokumentacija se ne vraća.

Samo kandidati koji se nađu u uskoj listi biće kontaktirani i pozvani na intervju.

Nusret Čubreli

Izvršni Šef

Datum: 18.06.2019

E jashtëzakonshme

I dështon magjia, zhduket 40-vjeçari

Një magjistari indian, i cili u zhyt në lumë, i lidhur me zinxhirë dhe litar, u gjet i vdekur. Chanchal Lahiri, i njohur me emrin e skenës 'Jadugar Mandrake' (Wizard Mandrake), u ul me çikrik në lumin në Kolkata të dielën me një kostum të verdhë dhe të kuq. Por 40-vjeçari me këmbët dhe krahët e lidhur fort dështoi të



dalë nga uji. Pamje dramatike kanë dalë të hënën nga çasti kur ai u fut në ujë.

BARSOLETA E DITËS



Lajmi:

- Alo, i dashur, do të tregoj si i kam dhënë sot veturës apo do ta marrësh vesh nga gazetatat?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton





FOTO E DITES



Një fotografi e shprehur nga lart tregon një imazh 68 metra të një balene të formuar nga mbeturinat plastike. /AFP/

Ne ora 16:00 dhe 19:00 “AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min


Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



E rrallë

Treni i këput krahun, mjekët ia ringjisin

Një baba 28-vjeçar indian, i cili e preu krahun e tij nga një aksident me tren, i është nënshtruar një operacioni për ta ringjitur. Ahmedabad Gujarat ishte duke pritur që të hipte në tren, kur papritmas ra në një hendek midis trenit dhe platformës. Fatmirësisht arriti që të shpëtonte, ndonëse krahu iu këput. Mijtë e tij nxituan në spital teksa mbanin në dorë krahun e palëvizur



në një qese plastike. Ai u pranua në njësinë e kirurgjisë plastike muajin e kaluar ku mjekët kryen një operacion prej shtatë orësh për ta rifituar gjymtyrën.



16.05.2019

“THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Fokusohuni tek financat sot sepse çdo gjë tjetër do të shkojë qetë gjatë ditës. Edhe pse jeni të shqetësuar për një problem do t'i jepni zgjidhje.



DEMI

Një çështje e rëndësishme biznesi sot do t'ju mbajë nën tension gjatë gjithë ditës. Nuk do t'i jepni dot zgjidhje të shpejtë.



BINJAKËT

Edhe pse sot jeni disi ëndërrimtarë përsëri nuk e keni humbur kontaktin me realitetin. Qëndroni me këmbë në tokë.



GAFORRJA

Momenta kreativiteti sot për ju dhe qëndrim në ambiente artistike ku doni të mësoni gjëra të reja.



LUANI

Sot nuk jeni të kënaqur nga ana sentimentale. Ndjenjat që provoni për dikë nuk kompensohen në mënyrë reciproke dhe kjo gjë ju mërzit.



VIRGJERESHA

Dita juaj sot nuk ka vetëm ngjyrat e entuziazmit që ju shoqëron gjithmonë por edhe ato të pasionit. Jeni shumë sharmantë.



PESHORJA

Tensionet dhe keqkuptimet e të shkuarës dalin në pah gjatë ditës së sotme. Debate të ashpra priten gjatë pjesës së dytë të ditës.



AKREPI

Sot ndiheni romantike dhe doni të qëndroni vetëm pranë njeriut të zemrës. Kushtet e ditës nuk ua lejojnë këtë gjë për shkak të angazhimeve.



SHIGJETARI

Me në fund keni filluar të lëvizni në fushën e financave sepse po shikoni që të tjerët kanë marrë përfitimet e investimeve tuaja.



BRICJAPI

Mijtë do t'ju lënë hapësira veprimi gjatë ditës se sotme sepse e dinë që ju keni qejf të bëheni protagonist në rrethin shoqëror.



UJORI

Mungesa e anës financiare sot do t'ua vështirësojë punët por ju nuk i shtrini këmbët asnjëherë me tepër se jorgani, kështu që duhet të menaxhoni ato që keni.



PESHQIT

Edhe pse sot është ditë pune ju ndiheni sikur e keni pushim. Nuk keni dëshirë fare t'i përkushtoheni impenjimeve tuaja.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Llapi u braktis nga lojtarët që lavdëroheshin nga Batatina

Hamdi Namani, Ahmed Januzi dhe Ilir Blakçori janë vetëm disa nga lojtarët që e braktisën Llapin në këtë afat kalimtar. Të njëjtit u lavdëroheshin pandërprerë gjatë kampionatit të fundit nga trajneri Tahir Batatina, por duket se vlerësimet dhe lëvdatat e tepërta nuk mjaftuan që ata të mbesin pjesë e skuadrës nga Podujeva edhe në edicionin 2019/2020

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, në opinionin njihet për deklaratat bombastike. Një e tillë kishte qenë edhe pak javë para fundit të kampionatit, kur futbollistët që i drejtonte i vlerësoi si më profesionistët në Kosovë dhe se janë në gjendje ta japin "shpirtin" në fushë për trajnerin e tyre, pra për Batatinën. "Lojtarët për mua janë në gjendje të vdesin në fushë për t'i arkëtuar pikët e plota dhe kjo më bën të ndihem komod kur kam punë me 'luana' të vërtetë dhe djemtë më të mirë në Kosovë i kam në skuadër", kishte deklaruar Batatina. Mirëpo kjo në praktikë i doli e kundërta, pasi shumë nga këta futbollistë më të përfunduar kampionati e braktisën Llapin dhe trajnerin Batatina. Një nga këta lojtarë ishte edhe kapiteni Hamdi Namani, i cili u largua pas plot gjashtë vjetësh. Po ashtu, nga Llapi u larguan edhe lojtarët më emër si Ahmed Januzi, Edon Zeqiri Hamdi, Egzon Sinani dhe Ilir Blakçori. Ndërsa i fundit që u largua është portieri Eglant Haxho. Ky i fundit largimin nga Llapi e ka konfirmuar të hënën nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Nuk do të jem më pjesë e Llapit. Edhe pse kishim një marrëveshje verbale, ajo nuk u realizua deri në fund. Pas pritjes nga ana ime për të pasur kontratë të detajuar, asgjë nuk erdhi në adresën time dhe e ndjeva të domosdoshme ta bëj këtë njoftim, edhe pse i vështirë", ka shkruar Haxho, i cili ka falënderuar tifogrupin 'Legjendat', bashkëlojtarët, drejtuesit e klubit, zyrtarët dhe gjithë shtabin teknik. E paqartë vazhdon të jetë e ardhmja e mesfushorit Mentor Zhdrella edhe përkundër asaj se Tahir Batatina e ka konfirmuar se marrëveshja është arritur dhe se katër herë lojtari më i



mirë në Kosovë do të jetë edhe kapiteni i Kosovës. Po ashtu, ende nuk dihet se a do të jetë pjesë e skuadrës nga Podujeva në edicionin 2019/2020 sulmuesi Festim Alidema, i cili ka qenë ndër lojtarët më të mirë në Kosovë për edicionin e fundit.

SHKURT

Gashi largohet nga Vëllaznimi

Kushtrim Gashi nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Vëllaznimit në edicionin e ri futbollistik. Mesfushori e konfirmoi largimin nga skuadra kuqezi nëpërmjet një statusi në "Facebook". "Pas tre vjetësh erdhi koha të ndahemi me Vëllaznimit. Faleminderit presidentit të klubit, Agim Cana dhe të gjithë trajnerëve që e drejtuan klubin në këta tre vjet, shoqërinë, tifozët fantastikë 'KZJ-1927' dhe të gjithë qytetarët e Gjakovës. Besoj se kam dhënë gjithçka nga vetja ime që një ditë të jem i mirëpritur në Gjakovë", ka shkruar Gashi. Largimin nga skuadra e Vëllaznimit të dielën e bëri edhe Samir Sahitin.

Fjolla, e artë në Çeki

Boksierja nga Kosova, Fjolla Qunaj, e ka fituar medaljen e artë në turneun ndërkombëtar "Klokočov" që u mbajt gjatë fundjavës në Republikën e Çekisë. Qunaj, në kategorinë deri në 52 kg, fitoi dy luftëra. Në finale mundi polaken Alexas Kubicki. Lirie Mazreku (-57 kg) dhe Anamaria Koni (-60 kg), fituan medaljet e argjendta falë shortit që i dërgoi në finale pa luftë.

Muriqi, afër huazimit të Nottingham Forestit

Portieri i Kosovës në futboll, Arijanet Muriqi, pritet të huazohet në skuadrën e Nottingham Forestit. "Daily Mail" raporton se trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka vendosur se portieri i talentuar të huazohet në skuadrën Nottingham Forestit për ta fituar përvojën e duhur dhe më pas për t'u rikthyer sërish në skuadrën e Cityt.

Pensionohet Enis Alushi

Ish-futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Enis Alushi, i ka dhënë fund përfundimisht karrierës si futbollist. 33-vjeçari tash e tutje do t'i përkushtohet punës së re, asaj të menaxherit të futbollistëve. Lajmin për pensionimin e Alushit e ka bërë bashkëshortja e tij, Fatmire Lira Alushi, përmes rrjetit social "Instagram". "Pas 15 vjetësh në futbollin profesionist, ti tash do ta nisësh një rrugë të re si menaxher i futbollistëve në agjenci të njohur. Do t'i mbetesh besnik futbollit sepse e do shumë. Ariani, Ela dhe unë jemi mjaft krenarë me ty. Gjithmonë ke bërë gjithçka për ne. Të urojmë çdo të mirë i dashur. Edhe pse është ndonjëherë e mërzitshme që duhet të jesh në telefon për shumë kohë, ne do të të mbështesim gjithmonë. Faleminderit që më bën të lumtur", ka shkruar ish-futbollistja e njohur shqiptare Fatmire Lira Alushi.

Kosova më 16 korrik debuton në Botëror

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Pas ndeshjeve të Përfaqësueses A me Poloninë dhe Gjermaninë është koha për Kampionatin Botëror për Juniorë (U21) që zhvillohet në Spanjë prej 16 deri më 28 kor-

rik. Përfaqësuesja e Juniorëve të Kosovës do të grumbullohet sot (e martë) për t'i filluar përgatitjet për kampionatin e parë botëror në të cilin merr pjesë Kosova në sportet ekipore. Organizatori

tashmë ka bërë publik orarin, kurse "Dardanët" e rinj ndeshjen e parë e luajnë më 16 korrik ndaj Kroacisë, në Pontevedra nga ora 18:00. Në Pontevedra i luajnë të gjitha ndeshjet në Grupin C.

Kosova më 18 korrik do të përballë me Hungarinë, ndërsa një ditë më vonë përballë me Portugalinë. Më 21 korrik Kosova luan ndaj Brazilit, kurse një ditë më vonë ndaj Bahrejnit.



Avdyli prezantohet te Kukësi

KUKËS, 17 QERSHOR - Skuadra e Kukësit po vazhdon përforsimet për edicionin e ri futbollistik. Pas Emiljano Mustës dhe Markovanbasten Çemës, Kukësi ka zyrtarizuar edhe portierin Ilir Avdyli i cili ishte pjesë e Përfaqësueses së

Kosovës. 29-vjeçari ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me nënkampionët e Superiores tekta do të luftojë për një vend titullari me gardianin Stivi Frashëri. Avdyli në të kaluarën ka veshur fanellën e KEK-ut, Drenicës,

Ferizajt, Hajvalisë, Tiranës, Llapit, Shkëndijës së Tetovës. Sezonin e fundit 29-vjeçari nga Podujeva ishte pjesë e Kamzës, skuadër që u përjashtua nga FShF pas dhunës së ushtruar ndaj gjyqtarit Eldorian Hamiti.



Karabegu: Të përfaqësojmë sa më mirë Kosovën në Evropian

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Basketbollistët e Kosovës U-20 janë duke u përgatitur intensivisht për Kampionatin Evropian, Divizioni B, që mbahet nga 12 deri më 21 korrik 2019, në Matosinhos të Portugalisë. Të përzgjedhurit e Ibrahim Karabegut janë duke u stërvitur dy herë në ditë, për të pasur një përfaqësim sa më të mirë në këtë garë shumë të rëndësishme. "Kampionati ka përfunduar më herët dhe lojtarët kanë hasur në vështirësi fizike. Megjithatë, jemi duke u stërvitur dy herë në ditë. Përgatitjet fizike po i mbajmë në Gërmi dhe Taukbashçe, kurse atë taktik në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë dhe në Obiliq. Lojtarët po japin maksimumin në stërvitje dhe kjo është shumë e rëndësishme për mua", është shprehur përzgjedhësi i Kosovës U-20 (meshkujt), Ibrahim Karabegu. Kosova U-20 ka zhvilluar edhe një ndeshje miqësore me Maqedoninë Veriore, duke pësuar 68:67, kurse nga 21 deri më 23 qershor do të jetë pjesëmarrëse në turneun që mbahet në Shkup, ku do të ballafaqohet me Rusinë, Maqedoninë Veriore dhe Malin e Zi. "Tashmë do të kemi edhe një turne në Maqedoninë Veriore,



ku do të luajmë edhe kundër Rusisë dhe Malit të Zi, që janë kombëtare favorite për kampion në Divizionin B. Këto ndeshje do të na shërbejnë ta shohim formën e lojtarëve dhe mangësitë që i kemi. Pra, t'i eliminojmë mangësitë para Kampionatit Evropian në Divizionin B. Ne kemi 14 lojtarë momentalisht, dy janë eliminuar më herët dhe lista do të shkurtohet në 12 pas turneut në Maqedoni", ka shtuar Karabegu. Kosova në Evropian është në

Grupin C së bashku me Suedinë, Holandën, Gjeorgjinë, Estoninë dhe Armeninë. "Nuk kemi ambicie për ndonjë vend në Evropian. Synimi ynë është ta përfaqësojmë sa më mirë shtetin e Kosovës në këtë garë shumë të rëndësishme. Unë dua të fitoj në çdo ndeshje. Kështu e kam mentalitetin. Kundërshtarët e Kosovës janë shumë të mirë, pasi kanë edhe më shumë përvojë", është shprehur trajneri Karabegu. Tri kombëtalet e para nga Divizioni B kalojnë në atë A.

Rosbergi: Kjo është dobësia më e madhe e Vettelit

BERLIN, 17 QERSHOR - Nico Rosberg, ish-kampioni i botës në Formula 1, i vetmi që ka mundur ta ndalë Lewis Hamiltonin, ka deklaruar se penaliteti që piloti gjerman i Ferrarit, Sebastian Vettel, mori në garën e Kanadasë, ishte i drejtë. Madje ai shkon më tej, duke zbuluar edhe shkaku e atij gabimi të katër herë kampionit të botës. "Unë e njoh mirë Lewisin dhe kur e ke nga pas për një orë e gjysmë, gabimi i atij që është para është i paevitueshëm. Për më tepër kur bie fjala për Vettelin që nën presion gjithnjë gabon. Ky është defekti i tij më i madh, nuk e përballon dot presionin e një piloti që e ndjek nga pas për shumë xhiro. Kjo ndodhi edhe në Kanada, doli jashtë pistës", ka thënë Rosbergu.



"Vetteli u përpoq t'i limitojë demet. Është më e lehtë të jesh nga pas sesa para. Sa herë që Lewisi është pas Sebastianit ndodh gjithnjë e njëjta gjë, fiton Hamiltoni. Ai e vë nën

presion Vettelin. Kjo gjë ndodh prej vitesh tashmë dhe Vetteli vazhdon të gabojë. Për pasojë, penaliteti ishte i paevitueshëm nga komisarët", ka deklaruar Rosbergu.

SHKURT

Mavraj: Ndeshjet e Kosovës i kam parë me lot gëzimi

Mërgim Mavraj ishte një prej yjeve që mori pjesë në ndeshjen e bamirësisë, e cila u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kapiteni i Kombëtares shqiptare ishte pjesë e skuadrës së Granit Xhakës, e cila barazoi 4-4 kundër asaj ku kapiten ishte Milot Rashica dhe paratë nga të ardhurat e biletave të shitura u shkuan familjeve në nevojë. Në fjalën e tij për "ART Sport", qendërbrojtësi foli për Përfaqësuesen e Kosovës. "Ndeshjet e Kosovës i kam parë me lot gëzimi. Unë jam kosovar, prindërit e mi janë lindur dhe rritur në Kosovë, ndaj më bëhet qejfi që djemtë po i zbatojnë siç duhet detyrat e trajnerit. Lakmi? Jo, aspak! Vetëm mirënjohje për të gjitha të mirat që më ka dhënë Zoti, pasi jam shpërblyer me shumë gjëra. Edhe me Kombëtares e Shqipërisë kemi arritur shumë gjëra të mira. Unë besoj se të gjithë këto që po gëzohen tani për Kosovën janë gëzuar disa vjet më parë për kuqezinjte", ka thënë Mavraj.

Totti largohet nga Roma

Legjenda Francesco Totti ka mbajtur konferencën për shtyp në të cilën ka njoftuar largimin nga Roma. Totti edhe zyrtarisht e ka lënë rolin si drejtor i 'Giallorossit', duke rritur distancën mes tij dhe pjesës tjetër të hierarkisë së tyre. Duke vepruar kështu, ai do t'u japë fund 30 vjetëve të shërbimit ndaj Romës pas 786 paraqitjeve si lojtar, para daljes në pension në vitin 2017. "Nuk ishte faji im sepse kurrë nuk kam pasur rastin të shprehem vetë. Nuk kam qenë kurrë i përfshirë në një projekt të mirëfillt teknik. Në vitin e parë, kjo mund të ndodhë. Në të dytën, e kuptoja atë që dëshiroja të bëja dhe kurrë nuk u mblodhëm bashkë, asnjëherë nuk ndihmuam njëri-tjetrin", ka thënë Totti. "Ata i dinin qëllimet e mia dhe atë që dëshiroja, t'i jepja aq shumë këtë klub dhe ekipi, por ata kurrë nuk donin që unë të bëja një gjë të tillë, me gjithë sinqeritetin. Ata më përjashtuan nga çdo vendim", ka shtuar Totti.

Coutinho në United si zëvendësues i Pogbas

Barcelona po kërkon që të largojë Phillipe Coutinhon. Futbollisti brazilian ka lënë gjurmë në Premierë Ligë me fanellën e Liverpoolit dhe zërat e merkatos flasin për mundësinë e rikthimit të tij në kampionatin anglez duke qenë se ai është vënë në shënjestrën e Manchester Unitedit. 27-vjeçari shihet si zëvendësues i Paul Pogbas, i cili pritet të transferohet në Real Madrid.

Al-Khelaifi, yjeve: Kush dëshiron mund të largohet


Presidenti i Paris Saint-Germain, Nasser Al-Khelaifi, ka shpërthyer me deklaratën e dhënë së fundmi, duke kërkuar më shumë përgjegjësi nga lojtarët. Gjiganti francez ka shpenzuar miliona euro për të ndërtuar një skuadër konkurruese në Evropë por, fatkeqësisht, deri tani ata nuk kanë arritur të prekin më shumë sesa çerekfinalët e Ligës së Kampionëve. Veç të tjerash, kampioni i Ligës 1 në dy sezonet e fundit është parë me probleme në dhomat e zveshjes, me Edinson Cavanin dhe Neymarin si dy aktorët kryesorë. Al-Khelaifi në një intervistë për "France Football" është treguar i ashpër me atë se çfarë po ndodh me ekipin e tij: "Nuk dua më gjëra të tilla. Lojtarët do të duhet t'i marrin përgjegjësitë e tyre edhe më shumë se më parë. Duhet të jetë krejtësisht ndryshe. Ata do të duhet të bëjnë më shumë, të punojnë më shumë. Ata nuk janë këtu për ta kënaqur veten. Nëse nuk pajtohen, dyert janë të hapura. 'Ciao!'".

Bayerni e kërkon si huazimin Balen

Bayern Munchen po kërkon për zëvendësuesit e Arjen Robbenit dhe Franck Riberyt. Ideja e fundit quhet Gareth Bale. Uellsiani i Real Madridit është me valixhe gati, pasi trajneri Zinedine Zidane nuk e sheh më pjesë të skemave të tij. Për 30-vjeçarin ka interesim nga Anglia, por ai mund të përfundojë në Bundesligë. "Bavarezët" po synojnë ta përsërisin të njëjtën skemë që ndoqën me James Rodriguezin. Sipas raportimeve të "The Sun", gjiganti gjerman synon ta marrë Balen në huazim njëvjeçar me të drejtë blerje verë e ardhshme.



Shpallje Publike



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës, Seksionin V, Piken 3 (c) të Rregullores së KEK Sh.A dhe në bazë të sistemes organizative të aprovuar të Zyrës së Auditimit të Brendshëm...

Auditor i Lartë Financiar (2 vende pune)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Të vlerësojë ekspozimet ndaj rreziqit që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës...

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Të zhvillojë dhe të dokumentojë një plan për secilin angazhim (angazhim në rastin e auditimit) duke përfshirë objektivat, objektin, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet:

- Diplomë Universitare në: Ekonomi, Financa Publike dhe Kontabilitet.

Shkathësitë tjera:

- Njohuri të thellë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar duke përfshirë afërsisht të interpretuar dhe zbatuar ato.

Auditor i Lartë Operativ (1 vende pune)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Të vlerësojë ekspozimet ndaj rreziqit që kanë të bëjnë me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacioneve të organizatës në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të organizatës...

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Të zhvillojë dhe të dokumentojë një plan për secilin angazhim (angazhim në rastin e auditimit) duke përfshirë objektivat, objektin, kohën dhe shpërndarjen e burimeve të angazhimit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Ekonomi, Juridik, Elektro-Energjetik, Teknologji Informative.

Shkathësitë tjera:

- Njohuri rreth funksionimit të ndërmarrjeve publike si dhe industrisë së prodhimit. Të jetë i pavarur dhe objektiv gjatë kryerjes së punës dhe të ketë afërsisht të larta analitike.

Auditor - Praktikant (4 Praktikant)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

- Auditori - praktikant në punën e tij të përditshme do të përcjellë punën praktike të auditimit të brendshëm me qëllim që pas periudhës gjashtëmujore të praktikantit të jetë i përgatitur në të gjitha aspektet që të kryejë punën e një auditori.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet:

- Përgatitje Universitare në këto fusha: Ekonomi, Juridik, Administratë Publike, Elektro-Energjetikë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitën e publikuar dhe konform tyre të dërgojnë Dëshmitë për kualifikimet profesionale të kërkuara.

Aplikacionet mund të merren në faqen tonë zyrtare të internetit www.kek-energy.com dhe të dërgohen në adresë elektronike ofertapune@kek-energy.com.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta refuzohen.

Prishtinë, Data e aplikimit deri më 01.07.2019, ora 16:00.



Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Xhevë Lladrovci" Komuna: Drenas Data: 18.06.2019

Table with 2 columns: Numri i kontratës: ESIP/SDG/143-CS/1.3, Emri i kontratës: Trajnim: Gjithëpërfshirja

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit...

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar...

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: Gjithëpërfshirja

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014...

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Xhevë Lladrovci", Drenas më së largu deri më datën; 26.06.2019

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Valdet Nika Telefoni: 049/978-533 E-maili: valdetnika@hotmail.com

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Vëllezërit Frashëri" Komuna: Prizren Data: 18.06.2019

Table with 2 columns: Numri i kontratës: ESIP/SDG/91-CS/1.3, Emri i kontratës: Trajnim: Orientimi në karrierë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit...

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme;

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënie në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e ngjashme (40%);

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014...

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Miran Ferati Telefoni: 049/337979 E-maili: mirock_508@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinički Centar Kosova University
Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik; Nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12, neni 13 pika 1 dhe neni 15 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; Nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; Nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016 dhe Kërkesa nr. 163, të datës 07.06.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

- **Mjekë Specialistë Infektolog në Klinikën e Sëmundjeve Ngjithëse (1 pozitë)**

I. Koefficienti i pagës: (8.4) Për Mjekë Specialistë
Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Shefit të Repartit të Klinikës
Nr. i Referencës: QKUK - 30/2019-06/1

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Specialistë:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka.

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitë profesionale dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të Endokrinologjisë;
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnim të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme;
- Letërnjoftimi fotokopje ose leja e banimit të përkohshëm, dhe
- Certifikata e lindjes, fotokopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë, shtetas të Republikës së Kosovës, Mjekë specialist të lëmisë përkatëse që nuk janë të punësuar në Institucionet Publike Shëndetësore.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit të QKUK-së, ndërtesa e re e Administratës ose me Telefon nr. 038/512-667.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit. Nuk do të pranohen aplikacione ndryshe nga dëshmitë që kërkohen në këtë konkurs.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas këtij konkursi, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)- Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Universitetski Klinički Centar Kosova - University Clinical Center of Kosovo
Kadrovska Sluzba

Prma članu 8, tačka 1 i 2, Zakona o radu br. 03/L-212, člana 4, Administrativnog Uputstva (MRSZ) Br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 6. tačka 1.1 i član 13 tačka 1 i 3. Statuta Bolničke Službe i Univerzitetskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), člana 12 i član 13 tačka 1. Statuta Kliničkog Univerzitetski Centra Kosova; kao i član 62, stav 6, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo; Član 5, Uredbe o Radnim Odnosima br. 1003 datum 21.07.2016; i Zahtev br. 163, dana 07.06.2019, Generalni Direktor UBKSK, raspisuje:

JAVNI KONKURS

Institucije: Universitetski Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Univerzitetski Klinički Centar Kosova (UKCK)

- **Doktori specijalisti za Infektivne Klinike u Infektološkoj Klinici (1 pozicija)**

Koefficient zarade: (8.4) Za Lekara specialista,
Radna Vreme: Puno radno vreme,
Ugovor:
Izveštaj: Šefu Odeljenja za Klinike.
Referentni br. UKCK- 30/2019-06/1

Osnovna svrha posla - za specialista:

Pružanje zdravstvenih usluga u pogledu kvaliteta i kvantiteta zasnovane na profesionalnom nivou koj je ima.

Ključne odgovornosti lekara specijalista:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalih nadzornog osoblja upravlja ljudskim resursima, opreme, objekata inventar za nivo na kome pripada.
- Obezbediti visok standard nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje za pacijente i osoblje radi.
- Ljubaznost i saradnja sa drugim osoblje koje radi profesionalno.
- Prijem, ispitivanje i lečenje pacijenta u pitanju.
- Redovno identifikaciju putem medicinske dokumentacije (istorija bolesti, otpusni list, protokol, itd) pacijenta.
- Izvršiti redovne posete bolničko lečenje u zdravstvenoj ustanovi.
- Napravljeni zahteva za dodatnim konsultativne posete,
- Vrši nadzor primene dnevnih radnih zadataka radne osoblja.
- Daje stručna mišljenja za rad koji obavljaju.
- Obavlja i druge poslove u skladu sa supervizora za rad u instituciji u kojoj je zaposlen.
- Vrši konkretne zadatke kada je to potrebno u vezi sa profesijom stručnjaka koji je blisko.
- Odgovoran je za izradu nastavnog plana i programa njegovog rada individualnih i kolektivnih na radnom

mestu,

- Angažuje osoblje koje radi u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- Obezbediti i razviti programe stručnog osposobljavanja,
- Vrši redovnu kontrolu (inspekciju objekata, opreme i inventara na radnom mestu).
- Proverite da li je okruženje je čist i bezbedan za sve,
- Upravlja potrošnog materijala i druge opreme,
- Obezbeduje efikasno sistema komunikacije za sve unutar institucije,
- Analizira i realizuje profesionalne protokole pacijenta,
- Učestvovanje u stručnim naučnim istraživanjima,
- Preduzima mere za povećanje menadžerskih kvalitete i jedinicu kolektivne na odeljenje (Jedinice)
- Izvršiti dodatne zadatke na osnovu njihove profesionalne kvalifikacije i upravljanje, itd
- Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom smislu zasniava na profesionalnom nivou tamo,
- Davanje stručne savjete u tumačenju o lečenju pacijenata i postavljanje dan tretmana,
- Odredi redosled i plan kliničko-laboratorijskih egzaminacija,
- Da bi se rad u klinici ambulantno i ispituje njihovu readmisiju.

Obrazovanje je potrebno: Da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti na osnovu specifičnosti institucije

- * Diploma Medicinskog Fakulteta;
- * Licenca specijalista za Endokrinologije;
- * Prioritet će biti dat kandidatima koji imaju posebnu obuku i dobro poznavanje funkcionisanja zdravstvenog sistema na Kosovu;
- * Da ima dokazali veštine i efikasne komunikacije u pismeno i usmeno, imaju znanje službenih jezika u upotrebi;
- * Poznavanje rada sa kompjuterom je od suštinskog značaja i znanje engleskog jezika je povoljno;
- * Licna karta fotokopija ili privremeni boravak i
- * Izvod matične knjige rođenih, fotokopija.

Uslovi učešća u zapošljavanju: pravo da se konuriše imaju svi građani Republike Kosova, odraslih koji imaju punu pravnu sposobnost, su završili svoje obrazovanje - lekari specijalisti, koji nisu zaposleni u institucijama za javno zdravlje.

Uslovi radova konkursa: Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.

Podnošenje konkursa: Aplikacija se uzimaju i dostavlja - Sektor kadrovski UKCK, u novoj Administrativne Zgrade ili telefonom br. 038/512-667.
U Aplikaciji treba jasno navesti naziv radnog mesta i referentni broj. Sva dokumenta i dokaz profesionalno da se pridruzi aplikaciju.

Podnete aplikacije po isteku roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Kandidati pruži dokaze pod objavljivanjem konkursa, kandidati koji inače ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Generalnog Direktora UBKSK



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Kancelaria Premijera-Office of the Prime Minister

Bazuar në nevojën e krijimit të ekipit të përkohshëm për zhvillimin e program Kompakt në mes të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të SHBA-së, shpallen këto pozita për angazhim të ekspertëve :

I. Një (1) Specialist i sektorit të energjisë
Numri i referencës: ZKM-ZSM-003

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Kombëtar kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Të udhëhequrit e diskutimeve të hollësishme të "shkaqeve rrënjësore" që përbëjnë bazën e kufizimeve të detyrueshme për rritjen ekonomike në Sektorin e Energjisë, duke punuar në koordinim të ngushtë me politikëbërësit e qeverisë, ekspertët e jashtëm, punonjësit e institucioneve ndërkombëtare donatore dhe akterët e tjerë.
2. Në emër të Ekipit të Zhvillimit të Kompaktit, të udhëhequrit e definimit të problemeve kritike, me të cilat ballafaqohet Sektori i Energjisë, identifikimit të strategjive të mundshme zbutëse, si dhe hartimit të Konceptit Dokumentit që shpjegon këto, në përputhje me udhëzimet e MCC.
3. Në emër të Ekipit të Zhvillimit të Kompaktit, të udhëhequrit e identifikimit të koncepteve potenciale të projektit dhe hartimit të Konceptit Dokumentit që propozon ndryshime të politikave, ndryshime ligjore, rregullatore ose institucionale ose investime publike ose private të nevojshme për suksesin e këtyre projekteve, në përputhje me udhëzimet e MCC.
4. Të udhëhequrit dhe të menaxhuarit e hartimit të termave të hollësishëm të referencës (TeR) për çdo studim fizibiliteti, vlerësime të ndikimit mjedisor ose social ose dizajn paraprak që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e projekteve dhe avancimin e procesit të zhvillimit të kompaktit.
5. Të ofruarit e udhëzimeve të hollësishme dhe konstruktive për konsulentët që mund të prokurohen për të ofruar analiza të hollësishme sektoriale ose institucionale, studime të fizibilitetit, vlerësime të ndikimit mjedisor ose social, ose dizajn paraprak, në bashkëpunim me akterët kryesorë dhe me MCC, dhe të siguruarit që konsulentët të kenë qasje tek të gjithë zyrtarët e Qeverisë, institucionet, anëtarët e stafit dhe të dhënat dhe informatat që mund të nevojiten për kryerjen e plotë, me kohë dhe me sukses të punës së tyre.
6. Të shqyrtuarit dhe të komentuarit e rezultateve sipas çdo studimi të fizibilitetit, vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe social ose punës së dizajnit paraprak - duke përfshirë planet e punës, afatet kohore dhe produktet substanciale - për të siguruar që të gjitha rreziqet, çështjet dhe shqetësimet teknike të trajtohen në mënyrë të duhur dhe të plotë.
7. Të krijuarit, të ruajtimit dhe të shfrytëzuarit në mënyrë efektive të marrëdhënieve me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe ministritë, departamentet apo agjencitë e tjera qeveritare që janë përgjegjëse për politikat mbikëqyrëse dhe zbatuese, ligjet dhe rregulloret në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
8. Të ndihmuarit në vlerësimin gjithëpërfshirës të kapacitetit teknik dhe menaxhues të ministrive, departamenteve ose agjencive qeveritare ose të ndonjë ndërmarrjeje publike që mund të përfshihen në mbikëqyrjen, menaxhimin ose zbatimin e ndonjë projekti të propozuar.
9. Të shërbyerit si pikë kryesore e kontaktit midis Ekipit të Zhvillimit të Kompaktit në Kosovë dhe grupit të praktikave të Energjisë të MCC dhe të siguruarit e rrjedhës së duhur të informacionit sipas nevojës për të mbajtur MCC të informuar siç duhet mbi progresin, çështjet dhe rreziqet.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë akademike në inxhinieri, planifikim, administrim, menaxhim projektesh, ose fushë tjetër përkatëse profesionale.
- Tetë (8) vite përvojë profesionale në menaxhimin e projekteve që përfshijnë sektorin e energjisë me një aftësi të demonstruar për të realizuar projekte inxhinierike të mëdha dhe komplekse në një afat të shkurtë. Njohja me aspekte të ndryshme të zhvillimit të projektit, duke përfshirë studimet e parafizibilitetit ose të fizibilitetit, vlerësimin e kostos, dizajnimin dhe/ose mbikëqyrjen e ndërtimit është e preferueshme.
- Njohuri të hollësishme të politikave të sektorit të energjisë, institucioneve të politikëbërjes, shërbimeve energjetike dhe industrisë së ndërtimit në Kosovë. Njohja me strategjinë e sektorit të energjisë në Kosovë, master planin dhe/ose planin strategjik të investimeve ka shumë përparësi.
- Aftësi të demonstruara për të bashkëpunuar në mënyrë efektive dhe konstruktive me politike bërësit publik, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët teknikë dhe të ndërtimit dhe palët e prekura nga projekti (PAP).
- Shkathtësi të zhvilluara komunikuese në të shkruar dhe të folur.

II. Një (1) Specialist për përfshirje sociale dhe integritet gjinor
Numri i referencës: ZKM-ZSM-005

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Koordinatorit Kombëtar kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Të kontribuojë në identifikimin e palëve të interesit dhe në zhvillimin e planeve për konsultime publike dhe angazhimin e palëve të interesuara dhe pastaj të udhëheqin organizimin, menaxhimin dhe zbatimin e kontakteve me ekspertët dhe organizatat që përfaqësojnë interesat e grupeve të varfëra, të disavantazuara sociale dhe grave, duke përfshirë organizatat që përfaqësojnë bizneset e grave .
2. Të mbajë konsultime të vazhdueshme me ekspertët dhe organizatat të tilla, institucione akademike dhe agjenci relevante qeveritare gjatë gjithë procesit të zhvillimit kompakt.
3. Vlerësimin e pengesave ligjore, institucionale, shoqërore dhe kulturore që kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike ose pengojnë zvogëlimin e varfërisë në mesin e grupeve dhe grave të varfëra, të pafavorizuara.
4. Të kontribuojë në identifikimin dhe zhvillimin e koncepteve fillestare dhe projekt propozimeve, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të Ekipit të Zhvillimit Kompakt për të siguruar që të merren mendimet për të reduktuar barrierat dhe për të zgjeruar pjesëmarrjen e grupeve të varfëra, të disavantazuara sociale dhe të grave në zhvillimin ekonomik në llogari .
5. Përpilimin e një logjike të detajuar të programit për projektet e propozuara dhe për programin e përgjithshëm kompakt, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të Ekipit të Zhvillimit Kompakt.
